“Tërhiqu ose do të vrasim ty dhe…”, kërcënonin biznesmenin nga Cërriku pasi fitoi tenderin, hetimi 1 mujor ‘fundosi’ shantazhuesit

10 Prill, 2023 15:49

Madhësia e tekstit:

Detaje të reja dalin në dritë në lidhje me arrestimin e 3 personave sot në Elbasan, të cilët akuzohen se kanë kërcënuar dhe shantazhuar prej disa kohësh 1 biznesmen.

Bëhet fjalë për shtetasit Algert Alcani, 27 vjeç, Edmir Boci, 37 vjeç, Shaqir Alcani, 62 vjeç, si dhe u shpall në kërkim shtetasi me inicialet L. K., 38 vjeç, për veprën penale “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, kryer në bashkëpunim.

Gazetari Igli Çelmeta raporton për BalkanWeb se ndonëse biznesmenit Erald Myftari, administrator i një biznesi me qendër në Cërrik, iu kërkua nga këta persona që të tërhiqej nga gara për tenderin, ai nuk kishte pranuar.

“Tërhiqu se do të vrasim ty dhe familjen tënde”, mësohet t’i kenë thënë autorët në fjalë biznesmenit. Ky i fundit i gjendur përballë kësaj situate, i është drejtuar policisë dhe pas një hetimi 1 mujor, janë vërtetuar dhe kërcënimet, ndërsa mbrëmë dhe sot janë kryer 3 arrestime, ndërsa 1 tjetër ndodhet në kërkim.

NJOFTIMI I POLICISE

Finalizohet pas një hetimi njëmujor me metoda proaktive, operacioni policor i koduar “Tenderi”. Operacioni, i zhvilluar nga strukturat hetimore të DVP Elbasan dhe Forca e Posaçme Operacionale në Policinë e Shtetit, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Operacioni ka nisur mbrëmjen e djeshme dhe ka vijuar deri mëngjesin e sotëm. Shtrënguan me anë të kanosjes, administratorin e një kompanie private, që të tërhiqej nga procedura e konkurrimit për tenderin që kishte fituar kjo kompani, vihen në pranga 3 shtetas, shpallet në kërkim 1 tjetër.

Specialistët e strukturave hetimore të DVP Elbasan, mbështetur nga inteligjenca informative se disa shtetas kishin kanosur administratorin e një firme në Cërrik dhe vijonin ta shtrëngonin që të tërhiqej nga një procedurë tenderimi që kishte fituar në bashkinë e Tiranës, kanë referuar materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila regjistroi procedimin penal.

Pas një hetimi proaktiv njëmujor, strukturat hetimore të DVP Elbasan, në bashkëpunim me Prokurorinë dhe me mbështetjen e Forcës së Posaçme Operacionale në Policinë e Shtetit, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar “Tenderi”.

Në kuadër të këtij operacioni u kapën dhe u ndaluan shtetasit: E. B., 37 vjeç, A. A. 27 vjeç dhe Sh. A., 62 vjeç, tre banues në Tiranë, si dhe u shpall në kërkim shtetasi L.K., 38 vjeç, për veprën penale “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, kryer në bashkëpunim.

Këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë shtrënguar me anë të kanosjes, shtetasin E. M., administrator i një biznesi me qendër në Cerrik, Elbasan, duke i kërkuar që të tërhiqej nga një procedurë konkurrimi (tender publik), e fituar në bashkinë e Tiranës, nga firma e që ai adminsitronte. Shtetasi E. M. nuk ka pranuar të tërhiqet dhe këta shtetas e kanë kërcënuar se do të vrisnin atë dhe familjarët e tij.

U sekuestruan në cilësinë e provës materiale automjeti i përdorur nga autorët dhe 8 aparate celulare. Materiale procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për veprime të mëtejshme.

(BalkanWeb)

Për t’u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t’ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: biznesmeni | Cerriku | shantazhet | tenderi

TË NGJASHME

Zgjedhjet lokale/ Meta shfaqet përkrah kandidatit për Bashkinë e Cërrikut: Optimist për 14 majin
09 Prill, 2023

Salep, pije energjike, kakao e çokollata/ Tenderi i luksit i Albcontrollit të Ballukut
31 Mars, 2023

Taboola Feed



You will never turn off your computer again. No Install. Play for free.
PanzerRush | Sponsored

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
No Install. Play for free.
Combat Siege | Sponsored
Play Now



SPAK, ka tashmë shefen e Marrëdhenieve me Publikun
SPAK, ka tashmë shefen e Marrëdhenieve me Publikun
balkanweb.com

If you have nail fungus, do this immediately
Eelhoe | Sponsored
Get Offer

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Masakra te ‘Don Bosko’ ku humbi jetën banakierja, zbulohen lëvizjet e një prej autorëve para ngjarjes në lokalin e Fatjon Muratit. Shmangu TIMS-in duke...
Klodiana Lala | 10 Prill, 2023

Raportohet për defekt elektrik në ashensor, rreth 40 minatorë bllokohen në minierën e Trepçës
10 Prill, 2023

I mituri shqiptar plagos me thikë bashkëmoshatarin e tij në Itali, tentoi t’i vidhte skuterin me forcë
10 Prill, 2023

EMRAT/ Shpërndanin kokainë në Sukth e Durrës, lihen në burg 7 të arrestuarit
10 Prill, 2023

“Historia u transformua në një thriller spiunësh nga…”, rusja blogere e akuzuar për spiunazh: Pasioni im për rrënojat më çoi në një burg në Tiranë
Vladimir Karaj | 10 Prill, 2023

“Më njoftuan prindërit ‘hajde se ndodhi hataja’”, vëllai i vrau gruan, flet bashkëshorti i 37-vjeçares: Rolandi ka qenë dikur në depresion, por...
10 Prill, 2023

KATEGORIA VIDEO

EKSKLUZIVE/ “Vandalë, kërcënuan me jetë”, kryetari i arbitrave kërkon masa drastike, Kastrati: Nëse nuk dënohen, shkojmë në bojkot (VIDEO)
10 Prill, 2023

Masakra te ‘Don Bosko’ ku humbi jetën banakierja, zbulohen lëvizjet e një prej autorëve para ngjarjes në lokalin e Fatjon Muratit. Shmangu TIMS-in duke...
Klodiana Lala | 10 Prill, 2023

“Tërhiqu ose do të vrasim ty dhe…”, kërcënonin biznesmenin nga Cërriku pasi fitoi tenderin, hetimi 1 mujor ‘fundosi’ shantazhuesit
10 Prill, 2023

“Kur s’i binden shantazhit, i sulmon si kriminel”, Ndoka për shembjen e “Prestige” dhe “luftën” e Ramës me Arbitrazhin: Pasojat do i ketë populli, inatet i ka personale
10 Prill, 2023

Puthi në buzë djalin e vogël dhe i kërkoi që t’i prekte gjuhën, Dalai Lama kërkon falje publike pas shpërthimit të rrjetit: Shaka e pafajshme
10 Prill, 2023

“Erion Braçe” e pyet pse është i sigurt në fitoren e zgjedhjeve, Berisha: Ne s’do ndërtojmë rrugë me 24 milionë euro, as ministret tona nuk do...
10 Prill, 2023

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Dy gëzime në një ditë?! Xhensila Myrtezaj shtatzënë për herë të dytë, ja fotot nga ditëlindja e këngëtares
10 Prill, 2023

Raportohet për defekt elektrik në ashensor, rreth 40 minatorë bllokohen në minierën e Trepçës
10 Prill, 2023

Koalicioni Berisha-Meta hap fushatën në 15 prill, ja vendi ku do mbahet mitingu
10 Prill, 2023

Rasti “Becchetti” si i “Hysenbelliu Grup!” Flet kreu i Konfindustria: Rama po bën të fortin me vendimet e Arbitrazhit
Valentina Madani | 10 Prill, 2023

Veliaj: Mandatin e ardhshëm, të gjithë kontejnerët e mbetjeve në zonën e qendrës do të futen nëntokë
10 Prill, 2023

Zgjedhjet presidenciale në SHBA, Joe Biden: Kam në plan të kandidoj në 2024-ën!
10 Prill, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE
@balkanweb

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.